

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Sylta, në lëndën penale kundër të pandehurit, B. A. , për shkak të veprës penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 , lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, , të cilën e përfaqësonte Prokurorja e Shtetit Huma Jetishi , pas mbajtes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe publik, më 25.10.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri B.A. , nga baba B.dhe nëna M., e lindur J., i lindur më ..në fshatin ,Komuna e, ku edhe jeton, ka te kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i pa martuar, i gjendjes se varfër ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë, si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër kundër tij,

ë s h t ë f a j t o r

S e p s e më ...,rreth orës...,minuta në fshatin..., në drejtim të GJ., derisai pandehuri kishte qenë duke e drejtuar automjetin e markës “...”, ka rrezikuar trafikun publik, duke evu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që me të arritur në udhëkryqin e fshatit me fhatin nga pakujdesia kalon në anën e kundërt, e në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 49.2 të Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, dhe me atë rast godet në pjesën e përparmë automjetin e markës “...”, të cilën e ka drejtuar M. S., nga Gj me ç’ rast përveq dëmeve materiale të shkaktuara në dy automjetet, lëndime të lehta trupore pësojnë tani i dëmtuari M.I . dhe pasagjerët e tijë : dhe vetë i pandehuri, të konstatuara në ekspertizën mjeko ligjore me nr. të referencës, të dt..

Me çka ka kryer veprën penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 , lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52 ,73 , 74 , 75 dhe 76 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurit , i shqipton,

Dënim me kusht

Ashtu që të pandehurit, B. M., i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda 2 (dy) viteve nuk kryen vepër tjetër penale.

I pandehuri Detyrohet që në emër të paushallit gjygjësor të arkëtojë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnimin e perbarimit të dhunshëm .

A r s y e t i m

Prokuroria Temelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë kundër të pandehurit B. A., për shkak të veprës penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 , lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën për shqyrtim fillestar më 25.10.2016, në të cilën kanë prezentuar Prokurorja e Shtetit , i pandehuri B. A., i dëmtuari B.A ndërkaq ka munguar i dëmtuari M.S.

Pas leximit të aktakuzës,i pandehuri B. A.,e ka kuptuar aktin e aktakuzës, përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 parag. 1 i KPPK-së, pas këtij njoftimi, i pandehuri e ka pranuar fajësinë, për veprën penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 , lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, në pajtim me përshkrimin faktik si në dispozitiv të aktakuzës.

Prokurorja e shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar : me qenëse i pandehuri në seancën e sotme të shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vëhet në barrë sipas kësaj aktakuze, dhe se i pandehuri B. A. është njoftuar paraprakisht nga ana e gjyqtarit për pasojat dhe benifitet e fajësisë, si dhe faktin se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat tjera materiale, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, fakte këto në baz të të cilave vërtetohet në tërësi se i njejt ka kryer veprën penale ashtu siq është përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze për çka mbetem në tërësi pran kësaj aktakuze dhe kërkoj nga gjykata që të njejtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Ndërsa si rrethana rënduese gjykata të ketë shkallën e përgjegjësisë penale , rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale , si dhe dëmin e shkaktur të dëmtuarve.

E dëmtuara A. L ka deklaruar : nuk i bashkangjitem ndjekjes penale nga fakti se deri te aksidenti ka ardhur pa dëshirën e të njëjtit, po ashtu heq dorë nga kërkesa pasuroro juridike për vete për djalin tim si dhe bashkshortin tim M. Snga fakti se ne e kemi realizuar kompensimin përmes kompanisë së sigurimit.

I dëmtuari B.S. ka deklaruar : nuk i bashkangjitem ndjekjes penale si dhe nuk kërkoj kompenzim dëmit sepse kompenzimin e dëmit e kemi realizuar përmes kompanisë së sigurimit .

I pandehuri B.A, në fjalën e vet përfundimtare, deklaron: se në tërësi e kam kuptuar aktakuzën e lexuar nga ana e prokurorit dhe veprën penale për të cilën akuzohem, e pranoj fajësinë për veprën penale e cila më vihet në barrë, pendohem për të njëjtën, iu kërkoj falje të dëmtuarëve për lëndimet e pësuar por e njoftoj gjykatën se deri të aksidenti në trafik ka ardhur nga pakujdesia, është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin, kështu që i premtoj gjykatës se në të ardhmen do të jemë, me i kujdesshëm në drejtimin e automjetit, me që jamë mbajtës i 7 anëtarëve të familjes, i pa punë dhe mezi ia dal që ta siguroj egzistencën e familjes, në fund kërkoj nga gjykata që mundësisht të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjyqtari ka vlerësuar se i pandehuri, e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi është bërë pasi që i njejt e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit nga i pandehuri është bërë vullnetarisht , i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza si dhe në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit.

Aktakuza po ashtu nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, prandaj në këtë çështje penale gjendja faktike ka qenë kontestuese, andaj gjykata ka gjetur se i pandehuri B. A., në vendin dhe kohën e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, ka kryer veprën penale, rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 , lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me kusht, si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të pandehurin , gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rendë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së.

Gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana veçanarisht lehtësuese të cilat mundësojnë shqiptimin e dënimit me kusht, përmes të cilit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 dhe 50 të KPRK-së. Si rrethanë lehtësuese për të pandehuren, gjykata pati parasysh faktin se i njejt i ka pranuar fajsinë për veprën penale të kryer, se i pandehuri është pa punësuar, se i njejt i për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin , si dhe faktin se i njejt i në kohën e kryerjes së veprës penale , ka qenë i moshës relativisht te re.

Ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin, gjykata pati parasysh, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale si lëndimin e shkaktuar të dëmturit.

Me dënimin e shqiptuar për të pandehurin , gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit, ashtu që të pandehurin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra tjera penale dhe se ky dënim do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale të kësaj natyre.

Për shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag. 1, e në lidhje me nenin 450 parag.1 nën parag. 2 .6 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i pergjithshëm.
P.nr.1133/15,më 25.10.2016**

Sekretarja juridike,
Rafete Syla,d.v.

Gjyqtari
Islam Thaçi,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.

P.nr.906/13

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Syla, në lëndën penale kundër të pandehurve: Ibrahim Sejfiu dhe Nderim Cani, për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë truporë nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ,lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II. nr. 1158/2013, të datës 24.06.2013, të cilën e përfaqësonte Prokurori i Shtetit Esat Ademi , pas mbajtes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe publik, më 07.03.2016 , mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Ibrahim Sejfiu , nga babai Mejdi dhe nëna Qazime e lindur, Dalipi, i lindur më datën 03.02.1995 në Gjilan, tani me vendëbanim në f.sh Llashticë K. Gjilanit, i pa punë , ka të kryer shkollën e mesme , i pa martuar, i gjendjes se varfer ekonomike , shqiptarë , Shtetas i Republikës së Kosovës, deri më tani e pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër kundër tij,

Ë s h t ë f a j t o r

S e p s e më 16.06.2013 rreth orës 20:00, në afërsi të Xhamisë në fshatin Llashticë, të pandehurit pas një mosëmarveshje paraprake para dy dite në Xhaminë e fshatit, me të dëmtuarin Egzon Rashiti , me të vrejtur këtë të dëmtuar në rrugë , të njejtin e sulmojnë fizikisht ashtu që i pandehuri i dytë Nderimi e kishte mbajtur- bllokuar duart, i pandehuri Ibrahim e kishte goditur me grushta në kokë duke i shkaktuar të njejtit lëndime të lehta trupore, i cili përshkak të lëndimeve të pësuar detyrohet të kërkojë ndihmë mjeksore në Emërgjencën e Spitalit Regjional te Gjilanit.

Me çka në bashkëveprim kan kryer veprën penale lëndim i lehtë truporë nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52 ,73 , 74 , 75 dhe 76 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të Pandehurit , i shqipton,

Dënim me kusht

Ashtu që të pandehurit i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri Ibrahim Sejfiu , brenda afatit prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjygjësor të arkëtojë shumën prej 30€, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përbarimi.

I dëmtuari Egzon Rashiti, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Temelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë kundër të pandehurve : Ibrahim Sejfiu dhe Nderim Cani , për shkak të veprës penale, lëndim i lehtë truporë nga neni 188 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën për shqyrtim fillestar në të cilën kanë prezentuar Prokurori i Shtetit Esat Ademi , i pandehuri Ibrahim Sejfiu, ndërsa i pandehuri Nderim Cani edhe për kundër faktit që është lëshuar urdhërarrest për shoqërim të dhunshëm dhe deri më tani nuk kemi konfirmim zyrtar për mos zbatimin e të njëjtës poashtu në seancë ka munguar edhe i dëmtuari Egzon Rashiti.

Pas leximit të aktakuzës i pandehuri Ibrahim Sejfiu e ka kuptuar aktin akuzues, përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata e ka njoftuar të pandehurit me të drejtat e tijë në kuptim të nenit 246 parag. 1 i KPPK-së, pas këtij njoftimi i pandehuri e ka pranuar fajësinë, për veprën penale, lëndim i lehtë truporë nga neni 188 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në pajtim me përshkrimin faktik si në dispozitiv të aktakuzës.

Gjykata duke vepruar konform nenit **36** të KPPK-së, e me qëllim të efikasitetit dhe azhuritetit të lëndës penale, ka veqar lëndën penale për të pandehurin Nderim Cani e që lënda

penale do të regjistrohet në numrtin vijues sipas rradhorit të gjykatës dhe do të procedohet ndaras.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar : pasi që i pandehuri në këtë fazë të procedurës e ka pranuar fajsinë për veprën penale, lëndim i lehtë truporë nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, po ashtu i njëjti , është njoftuar paraprakisht nga gjyqtari i vetëm gjykues, me pasojat dhe favoret e pranimit të fajsisë, kështu që pas këtij njoftimi i pandehuri vullnetarisht dhe pa presion e shtytje e ka pranuar fajsinë për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Prandaj i propozoi gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtorë dhe t'i shqiptoi një sanksion penal meritor, me bindje se dënimi i shqiptuar, do të ndikoj pozitivisht tek i pandehuri. Në fund kërkoj nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit për të pandehurin e sipërtheksuar, të ketë parasysh rrethanat lehtësuese edhe ato rënduese. Si rrethana lehtësuese gjykata të merr parashysh, pranimin e fajsisë për veprën e kryer, pendimin për të njëjtën , premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, gjendjen e vështirë ekonomike dhe sociale të tijë , si dhe faktin se është hera e parë që ndeshet me ligjin. -

Ndërsa si rrethana rënduese gjykata të ketë shkallën e përgjegjësisë penale , rrezikshmërinë shoqërore si dhe dëmin e shkaktur të dëmtuarit .

I pandehuri Ibrahim Sejfiu , në fjalën e vet përfundimtare, deklaron: si në fillim të seancës, edhe në fjalën përfundimtare e pranoj fajësinë për veprën me të cilën ngarkohem, pendohem për të njëjtën i kërkojë falje të dëmtuarit, ka qenë hera e parë që kam rënë në desh me ligjin kështu që e i premtoj gjykatës se nuk do të kry vepër të kësaj natyre, me që jam në gjendje të vështirë ekonomike- sociale, kërkoj nga gjykata që mbrenda mundësive të më shqiptojë një dënim sa më të butë.

Gjyqtari ka vlerësuar se i pandehuri, e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi është bërë pasi që i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit nga i pandehuri është bërë vullnetarisht , i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza si dhe në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit. Aktakuza poashtu nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, prandaj në këtë çështje penale gjendja faktike nuk ka qenë kontestuese, andaj gjykata ka gjetur se i pandehuri Ibrahim Sejfiu, në vendin dhe kohën e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, ka kryer veprën penale, lëndim i lehtë truporë nga neni 188 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Andaj të pandehurin e shpalli fajtorë dhe i shqiptoj dënimin me kusht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të pandehurin , gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së.

Gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana veçanarisht lehtësuese të cilat mundësojnë shqiptimin e dënimit të kushtëzuar, përmes të cilit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 dhe 50 të KPRK-së. Si rrethanë lehtësuese për të pandehurin, gjykata pati parasysh faktin se i njëjti e ka pranuar fajsinë për veprën penale të kryer, se i pandehuri është i pa punësuar, gjendjes së vështirë ekonomike, kështu që shqiptimi i dënimit me gjobë dhe i pakushtëzuar do të ndikonte negativisht , gjegjësisht do të përkeqësonte gjendjen e vështirë ekonomike të tijë dhe familjes dhe mbi këtë bazë të pandehurit i shqiptojë dënim të kushtëzuar.

Ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin, gjykata pati parasysht, shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarit .

Me dënimin e shqiptuar për të pandehurin , gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të pandehurin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra tjera penale dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag. 1, e në lidhje me nenin 450 parag.1 nën parag. 2 .6 të KPPRK-së.

I dëmtuari Egzon Rashiti, konform neni 463 të KPPK-ës për realizimin e kërkesës pauroro-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i përgjithshëm.
Më 07.03.2016 .**

Sekretarja juridike,
Rafete Sylja,d.v.

Gjyqtari
Islam Thaçi,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.

4.-

P.nr.1146/13

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Sylja , në lëndën penale kundër të pandehurit Egzon Zylfiu, për shkak të veprës penale, vjedhja nga nga neni 325 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II. nr. 1209/13, të datës 03.07.2013, të cilën e përfaqësonte Prokurori i Shtetit Esat Ademi , pas mbajtes së seancës së shqyrtimit fillestar dhe publik, më 07.03.2016 , mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Egzon Zylfiu , nga babai Nazif dhe nëna Fatime e lindur, Bajrami , i lindur më datën 04.05.1994 në Vrajë R. Serbisë, tani me vendëbanim në rr. Ismajl Kurteshi (fusha andit- rr. Malishevës, i pa punë , ka të kryer shkollën e filllore , i pa punë , i pa martuar, i gjnedjes se varfer ekonomike , shqiptare , Shtetase e Republikës së Kosovës, deri më tani e pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër kundër tij,

Ë s h t ë f a j t o r e

S e p s e më 30.11.2012 rreth orës 20:30, në Gjilan, në rrugën “ Lidhja e Prizerenit’të pandehurit me qëllim që vetit ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasurorë, ka kryer vjedhje në dëm të të dëmtuarës-Qendrës Tregtare “ Viva Fresh”, në atë mënyrë që të njejtit pasi hyjnë në lokalet e kësaj qendre tregtare, shkojnë tek sektori i pijeve alkoolike dhe që të dy marrin nga

një shishe alkool të llojit "Jack Daniels" të cilat i fusin nën jakne dhe pasi që e vërejnë se janë hetuar nga punëtorët e sigurimit fillojnë të vrapojnë dhe largohen në drejtim të panjohur, duke e dëmtuar kështu të dëmtuarën në vlerë prej 45 €,

-me çka ka kryer veprën penale, vjedhja nga neni 325 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52 dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit , i shqipton,

Dënim me kusht

Ashtu që të pandehurit i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve dhe dënim me gjobë në shumë prej 200 € (dyqindë) Euro, të cilat dënime nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari Shkelzen Bunjaku , brenda afatit prej 2(dy) viteve, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjygjësor të arkëtojë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

E dëmtuara-Qendra Tregtare"Viva Fresh", për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Temelore në Gjilan, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë kundër të pandehurit Egzon Zylfiu nga Gjilani , për shkak të veprës penale, vjedhja nga neni 325 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën për shqyrtim fillestar në të cilën kanë prezentuar Prokurori i Shtetit Esat Ademi , i pandehuri Egzon Zylfiu, ndërsa e dëmtuara-përfaqësuesi i Viva Fresh-it edhe përkundër faktit se ka qenë të ftuar në mënyrë të rregullt në seancë nuk kanë prezentuar dhe mungesen nuk e kanë arsyetuar.

Pas leximit të aktakuzës i pandehuri Egzon Zylfiu e ka kuptuar aktin akuzues, përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata e ka njoftuar të pandehurit me të drejtat e tijë në kuptim të nenit 246 parag. 1 i KPPK-së, pas këtij njoftimi i akuzuari e ka pranuar fajësinë, për veprën penale, vjedhja nga neni 325 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 i KPRK-së, në pajtim me përshkrimin faktik si në dispozitiv të aktakuzës.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar : pasi që i pandehuri në këtë fazë të procedurës e ka pranuar fajësinë për veprën penale, vjedhja nga neni 325 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 i KPRK-së, po ashtu i njejtë , është njoftuar paraprakisht nga gjyqtari i vetëm gjykues, me pasojat dhe favore të pranimit të fajësisë, kështu që pas këtij njoftimi i pandehuri vullnetarisht dhe pa presion e shtytje e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Prandaj i propozoi gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtorë dhe t'i shqiptoi një sanksion panal meritor, me bindje se dënimi i shqiptuar, do të ndikoj pozitivisht tek i pandehuri. Në fund kërkoj nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit për të pandehurin e sipërtheksuar, të ketë parasysh rrethanat lehtësuese edhe ato rënduese. Si rrethana lehtësuese gjykata të merr parasysh, pranimin e fajsisë për veprën e kryer, pendimin për të njejtën, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, gjendjen e vështirë ekonomike dhe sociale të tijë, si dhe faktin se është hera e parë që ndeshet me ligjin,

Ndërsa si rrethana rënduese gjykata të ketë shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore si dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarës Viva Fresh në Gjilan.

I pandehuri Egzon Zylfiu, në fjalën e vet përfundimtare, deklaroi: si në fillim të seancës, edhe në fjalën përfundimtare e pranoi fajësinë për veprën me të cilën ngarkohem, pendohem për të njejtën por kemi qenë të rinjë dhe në këtë rast kemi gabuar, duke i kërkuar falje të dëmtuarës Viva Fresh, dhe i premtoj gjykatës se nuk do të kryej vepra të kësaj natyre dhe me që jamë në gjendje të vështirë ekonomike, kërkoj nga gjykata që mbrenda mundësive të më shqiptojë një dënim sa më të butë.

Gjyqtari ka vlerësuar se i pandehuri, e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi është bërë pasi që i njejtë e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit nga i pandehuri është bërë vullnetarisht, i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza si dhe në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit. Aktakuza poashtu nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, prandaj në këtë çështje penale gjendja faktike nuk ka qenë kontestuese, andaj gjykata ka gjetur se i pandehuri Egzon Zylfiu, në vendin dhe kohën e përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, ka kryer veprën penale, vjedhja nga neni 325 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Andaj të pandehurin e shpalli fajtorë dhe i shqiptoj dënimin me kusht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të pandehurin, gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së.

Gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana veçanarisht lehtësuese të cilat mundësojnë shqiptimin e dënimit të kushtëzuar, përmes të cilit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 dhe 50 të KPRK-së. Si rrethanë lehtësuese për të pandehurin, gjykata pati parasysh faktin se i njejtë e ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer, se i akuzuari është i papunësuar, gjendjes së vështirë ekonomike, familja 6 anëtarëshe vetëm me të ardhura personale që i merr djali i tijë në shumë prej 200 €, kështu që shqiptimi i dënimit me gjobë dhe i pakushtëzuar do të ndikonte negativisht, gjegjësisht do të përkeqësonte gjendjen e vështirë ekonomike të tijë dhe familjes dhe mbi këtë bazë të akuzuarit i shqiptojë dënim të kushtëzuar.

Ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin, gjykata pati parasysh, shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarës – KEDS-it.

Me dënimin e shqiptuar për të pandehurin, gjykata vlerëson se do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të pandehurin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejë vepra tjera penale dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 paragraf 1, e në lidhje me nenin 450 paragraf 1 nën paragraf 2.6 të KPPRK-së.

E dëmtuara – Qendra Tregtare “Viva Fresh”, konform neni 463 të KPPK-ës për realizimin e kërkesës pauroro-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i përgjithshëm.
Më 07.03.2016 .**

Sekretarja juridike,
Rafete Sylaj, d.v.

Gjyqtari
Islam Thaçi, d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.

Pasë fjalëve përfundimtare të palëve, gjyqtari merr dhe publikishtë shpallë

NË EMËR TË POPULLIT

AKTGJYKIM

I pandehuri: Shpejtim Osmani me të dhënat personale si në shkresat e lëndës,

Është fajtorë

Ditën , kohën dhe vendin e përmendur si në dispozitivin e I|, të kësaj aktkauze , ka shkelur paragrafin 55.1 të nenit 55 të LSKRR-së , dhe me këtë ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre , ashtu që duke e drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës „ Opel Vectra „, me ngjyrë hiri metalike , dhe me targa të regjistrimit 06-128-BO , nuk ju është përmbajtuar dispozitave të ligjit në fjalë , që kanë të bëjnë me obligimin e shoferit sipas të cilit shoferi është i obliguar që të mos frenoj vullshëm përveq në rast të rrezikut të drejtpërdrejt , dhe atë duke e paralajmëruar me sinjalizim të dritave të frenimit , dhe me gjithë treguesit e drejtimit ose duke dhënë shenjë përkatëse me dorë , lehtë ka menduar se edhe përkundër veprimeve nuk do të shkaktoj pasojnë e ndaluar , ashtu që me të arritur në vendin e përmendur vullshëm frenon pa dhënë kurrëfar shenje , për shkak se nga ana e kundërt vëren se ishte duke ardhur automjeti i policies , me që rast e pengon duke zhvilluar shpejtësi normale të pandehurit e pare që ishte prapa tij duke e drejtuar automjetin e markës „ Mercedes, „ me ngjyrë hiri dhe me traga të regjistrimit 01-483-AF , dhe për pasojë nga prapa goditet prej këtij automjeti dhe me këtë rast përveq dëmeve material në vlerë të pa përcaktuar në automjetin e të pandehurit të pare , bashkëudhëtarve të vet –tani të dëmtuarve : Qibrije , Shqipe , Fidan , Besart , dhe Gentuar Osmani ju shkakton lëndime të lehta trupore në formë të ndryshjeve , dhe përdredhjeve në pjesë të ndryshme të trupit .

Me qka ka kryer veprën penale, Rrezikim I trafikut public nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së .

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52 dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurëve, iu shqipton,

Dënim me kusht

Ashtu që të pandehurit Shpejtim Osmani i shqipton burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, me kusht që i pandehuri brenda afatit prej 1 (një) viti , nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi mos të kryej vepër tjetër penale në të kundërtën dënimi me kusht ka për t` ju revokuar.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjygjësor të arkëtojnë shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

Të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarve : Qibrije , Shqipe , Fidan , Besart , Gentuar Osmani, nga fshati Llabjan , Komuna e Novobërdës ,për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në contest civil .

Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të aktgjykimit (të shkruar), në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Gjyqtari i vetëm gjykues e njofton të pandehurit se deri në përfundim të procedurës është i detyruar që ta njoftoi gjykatën për ndrrimin eventual të vendbanimit.

Prezentë Prokurorja e Shtetit i pandehuri dhe të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarëve .

Aktgjykimi u komunikua më 19.10.2015, në ora 11.40

V ë r t e t o j n ë :

Procesmbajtësja

Gjyqtari

P.nr.35 / 2015

Pasë fjalëve përfundimtare të palëve, gjyqtari merr dhe publikisht shpallë

NË EMËR TË POPULLIT

AKTGJYKIM

I pandehuri: Nebojsa Stanković me të dhënat personale si në shkresat e lëndës,

Është fajtorë

Më dt. 05.05.2015, rreth orës 19.00 , në lagjen e quajtur ,, Qeranovic,, në fshatin Kllabukar , Komuna e Novobërdës ,I pandehuri Nebojsa Stanković , me qëllim të përfimit të kundërligjshëm pasuror për vete , me dashje ka vënë në lajthim zyrtarët policor duke bërë lajmërim të rremë se kinse në shtëpinë e babait të tij , është kryer vepra penale e vjedhjes së rëndë , në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e vet aka lajmëruar rrejtshëm , për një vepër penale , e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare për të cilën e ka ditur se ajo vepër në fakt nuk është kryer .

Me qka ka kryer veprën penale, Lajmërimi apo kallximi I rremë , nga neni 390 paragrafi 4 I KPRK-së .

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52 dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurëve, iu shqipton,

Dënim me kusht

Ashtu që të pandehurit Nebojsa Stanković i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtë;dhjet;) ditëve, me kusht që i pandehuri brenda afatit prej 2 (dy) vitesh , nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi mos të kryej vepër tjetër penale ,e në të kundërten dënimi me kusht ka për t`ju revokuar.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjygjësor të arkëtojë shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të aktgjykimit (të shkruar), në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Gjyqtari i vetëm gjykues e njofton të pandehurit se deri në përfundim të procedurës është i detyruar që ta njoftoi gjykatën për ndrrimin eventual të vendbanimit.

Prezentë Prokurori i Shtetit dhe i pandehuri i lartëcekur.

Aktgjykimi u komunikua më 12.10.2015, në ora 15.10

V e r t e t o j n ë :

Procesmbajtësja

Gjyqtari

P.nr.33 / 2015

Pasë fjalëve përfundimtare të palëve, gjyqtari merr dhe publikishtë shpallë

NË EMËR TË POPULLIT

AKTGJYKIM

I pandehuri: Agim Vllasaliu me të dhënat personale si në shkresat e lëndës,

Është fajtorë

Më dt.21.05.2015 , rreth orës 18.00 h, në fshatin Izvor , Komuna e Novobërdës , I pandehuri seriozisht me fjalë ka kanosur të dëmtuarin Sllavisha Stojanoviq , në atë mënyrë që ka shkuar në shtëpinë e tij dhe të dëmtuarin seriozisht e ka kanosur duke I thënë : Agim Vllasaliu do të rrezikoj dhe do të bëhet burrë deri në fund dhe Sllavisha do ta lë token e tij në fshatin Izvor , sepse atë do ta marr Agim Vllasaliu , dhe se Agim Vllasaliu do të bëjë qka të dëshiron me tëtë familjene tij , duke shtuar se mundet të dëmtuarin ta largoj edhe nga puna – shërbimi policor , me që rast tek I dëmtuari Sllavisha , ka shkaktuar ankth , frikë dhe pasiguri për jetë .

Me qka ka kryer veprën penale, Kanosja nga neni 185 paragrafi 1 I KPRK-së .

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52 dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurëve, iu shqipton,

Dënim me kusht

Me denim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, me kusht që i pandehuri brenda afatit prej 2 (dy) vitesh , nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi mos të kryej vepër tjetër penale në të kundërtën dënimi me kusht ka për t` ju revokuar.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjygjësor të arkëtojnë shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të aktgjykimit (të shkruar), në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Gjyqtari i vetëm gjykues e njofton të pandehurit se deri në përfundim të procedurës është i detyruar që ta njoftoi gjykatën për ndrimin eventual të vendbanimit.

Prezentë Prokurori i Shtetit dhe i pandehuri i lartëcekur.

Aktgjykimi u komunikua më 12.10.2015, në ora 15.40

V e r t e t o j n ë :

Procesmbajtësja

Gjyqtari

P.nr.12 / 2015

Pasë fjalëve përfundimtare të palëve, gjyqtari merr dhe publikishtë shpallë

NË EMËR TË POPULLIT

AKTGJYKIM

I pandehuri:Basri Abazi , me të dhënat personale si në shkresat e lëndës,

ËShtë fajtorë

Më dt.15.09.2014,në kohë të papërcaktuar , në fshatin PAsjak , Komuna e Novobërdës , nga sektori I kalibrimit në Prishtinë , është konstatuar se I pandehuri në shtëpinë e tij , me qellim që vettit ti sjell përfitim të kunderligjshem pasuror , pa autorizim ka shpenzuar energjinë elektrike ne atë mënyre që në njehsorin elektrik me numer .601002882 , nga ana e djathtë e ka hapur një vrimë në kapakune njehsorit , ashtu që perms vrimës e ka penguar punën normale të diskut , kurse në brendi të njehsorit , është gjetur copa druri , me qka I njejt i ka pamundësuar regjistrimin e shpenzuar të energjisë elektrike , duke e dëmtuar KEDS-in , distrikti ne Gjilan në shumë prej 94.17 Euro

Me qka ka kryer veprën penale, Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-se .

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52 dhe 73 ,75dhe 76 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurit, iu shqipton,

Dënim me kusht

Ashtu që të pandehurit Bastri Abazi, i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve dhe dënimi me gjobë në shumë prej 150 (njëqindë e pesëdhjetë) Euro , të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse mbrenda afatit prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajve, nga dita e plotëfuqishmërisë nuk kryen vepër tjetër penale.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjygjësor të arkëtojnë shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të aktgjykimit (të shkruar), në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Gjyqtari i vetëm gjykues e njofton të pandehurin se deri në përfundim të procedurës është i detyruar që ta njoftoi gjykatën për ndrimin eventual të vendbanimit.

Prezentë Prokurori i Shtetit dhe të pandehurit të lartëcekur.

Aktgjykimi u komunikua më 12.10.2015, në ora 11.20

V e r t e t o j n ë :

Procesmbajtësja

Gjyqtari

P.nr.27 / 2015

Pasë fjalëve përfundimtare të palëve, gjyqtari merr dhe publikishtë shpallë

NË EMËR TË POPULLIT

AKTGJYKIM

I pandehuri:Rabit Sadriu , me të dhënat personale si në shkresat e lëndës,

ËShtë fajtorë

Më dt.13.02.2013, rreth orës 10.34min , në rrugën Gjilan –Prishtinë , në dalje të fshatit Slivovë, duke drejtuar automjetin e tipit,, Golf 19E,, ngjyrë e bronzët , me targa të regjistrimit 06-763-BM , nuk i është përmbajtur rregullave të komunikacionit në kundërshtim me nenin 64 të LSKRR-së , dhe ka vu në rrezik jetën e njerëzve , dhe ka menduar lehtë se në atë mënyrë nuk do të rrezikoj komunikacionin , kështu që në kthesë e humb kontrollin mbi veturën e tij duke kaluar në shirtin tjetër qarkullues , ku komunikacioni zhvillohej në kahje të kundërt dhe me pjesëne përparme e godet veturën ,, Opell Astra ,, me targa të regjistrimit 06-673-AB , pronë e Kuvendit Komunal në Novobërdë, të cilëne drejtonte i dëmtuari Kadri Zymberi , e i cili ishte në shiritin e vet të qarkullimit ku si pasojë e këtij aksidenti janë shkaktuar dëme materiale në automjete dhe lëndime të lehta trupore kanë marrë dy vozitësit dhe pasagjerët Bajram Emini , Xhemajl Sadria , Emrush Emini dhe Shaban Emini .

Me qka ka kryer veprën penale, rrezikim i tarfikut public nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së,

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52 dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurëve, iu shqipton,

Dënim me gjobë

Te pandehurin e gjykon me dënim me gjobë (me të holla) në shumë prej 200 €, (dyqindë) Euro, të cilin denim ka për ta pagaur në afat prej 3 muajve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit , në të kundërtën I njeiti do ti zëvendësohet me denim burgu , ashtu që për qdo 20 €,euro do të llogartiet nga një ditë burgim

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjygjësor të arkëtojnë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të aktgjykimit (të shkruar), në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Gjyqtari i vetëm gjykues e njofton të pandehurin se deri në përfundim të procedurës është i detyruar që ta njoftoi gjykatën për ndrrimin eventual të vendbanimit.

Prezentë Prokurori i Shtetit dhe të pandehurit të lartëcekur.

Aktgjykimi u komunikua më 21.09.2015, në ora 15.20

V e r t e t o j n ë :

Procesmbajtësja

Gjyqtari

P.nr.26 / 2015

Pasë fjalëve përfundimtare të palëve, gjyqtari merr dhe publikishtë shpallë

NË EMËR TË POPULLIT

AKTGJYKIM

E pandehura:Jagodica Gjorgjeviq me të dhënat personale si në shkresat e lëndës,

Është fajtores

Më dt.03.05.2015 , rreth orës 07.50 min në fshatin Kufcë e Epërme , Komuna e Novobërdës , I ka shkaktuar lëndime të lehta truporetë dëmtuarës Stojanka Stojković , në atë mënyrë që ditën kritike deri sa e dëmtuara Stojanka ishte duke mbjellë qepë , pas dhejtë minutave e pandehura JAgodica Gjorgjeviq , shkon tek ajo dhe fillon konflikti verbal , lidhur me një hua , që bashkëshortja e djalit (reja), e Stojakës Miljana , I kishte marrë hua burrit të saj , rreth 800 Euro , para 13 viteve , dhe e pandehura për huanë kishte dëgjuar nga bashkëshorti I saj para një muaji . Pas konfliktit verbal mes tyre e pandehura e merr një gur dhe e sulmon në kokë duke I shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe largohet nga aty , ndërsa Stojanka Gjorgjeviq lajmëron policinë , pot ë njejtën ditë policia e dërgojnë në Spitalin Regjional të Gjilanit – Emergjencë , e cila posedon raportin mjeksëor me nr të protokollit 8217, si dhe ekspertizën , mjeko ligjore me nr të references 29/05-15 , të dates 20.05.2015 , ku sipas konstatimit të ekspertit , janë konstatuar dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin .

Me qka ka kryer veprën penale, Lëndim I lehtë trupor , nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 I KPRK-së .

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52 dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurëve, iu shqipton,

Dënim me kusht

Me denim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, me kusht që e pandehura brenda afatit prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi mos të kryejnë vepër tjetër penale.

E pandehura obligohet që në emër të paushallit gjygjësor të arkëtojnë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

E dëmtuara Stojanka Gjorgjeviq , për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në contest civil.

Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të aktgjykimit (të shkruar), në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Gjyqtari i vetëm gjykues e njofton të pandehurit se deri në përfundim të procedurës është i detyruar që ta njoftoi gjykatën për ndrrimin eventual të vendbanimit.

Prezentë Prokurori i Shtetit dhe e pandehura të lartëcekur.

Aktgjykimi u komunikua më 21.09.2015, në ora 15.20

V e r t e t o j n ë :

Procesmbajtësja

Gjyqtari

Pasë fjalëve përfundimtare të palëve, gjyqtari merr dhe publikishtë shpallë

NË EMËR TË POPULLIT

AKTGJYKIM

I pandehuri: Agim Qerimi me të dhënat personale si në shkresat e lëndës,

Është fajtorë

Më dt.23.Dhjetor 2014 , rreth orës 10.00 min në fshatin Pasjak, Komuna e Novobërdës , I pandehuri Agim Qerimi, pas një mosmarrëveshje – grindje , me të dëmtuarin ramdan Ramabaja , ka lënduar të njejtin , në atë mënyrë që me një gur , mjet ky I përshtatshëm , për shkaktim të lëndimit të rëndë trupor , e godet në kokë , duke I shkaktuar të dëmtuarit lëndime trupore , I cili për shkak të natyrës së lëndimeve detyrohet të kërkoj ndihmë mjeksore , në emergjencën e spitalit regjional të Gjilanit me ç,rast I shkaktohet lëndim I lehtë trupor I përshkruar sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertit mjeko ligjor me nr.022 të dates 04.Shkurt 2015 .

Me qka ka kryer veprën penale, Lëndim I lehtë trupor , nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.4 I KPRK-së .

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,49,50,51,52,73,74,75dhe 76 të KPRK-së lidhur me dhe nenin 365 të KPPK-së, të pandehurit , i

shqipton,

Dënim me kusht

Me denim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, me kusht që i pandehuri brenda afatit prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi mos të kryejnë vepër tjetër penale.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjygjësor të arkëtojnë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

I dëmtuari Ramadan Ramabaja , për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në contest civil.

Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të aktgjykimit (të shkruar), në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Gjyqtari i vetëm gjykues e njofton të pandehurit se deri në përfundim të procedurës është i detyruar që ta njoftoi gjykatën për ndrrimin eventual të vendbanimit.

Prezentë Prokurori i Shtetit i pandehuri dhe I dëmtuari I lartëcekur.

Aktgjykimi u komunikua më 21.09.2015, në ora 14.00

Pasë fjalëve përfundimtare të palëve, gjyqtari merr dhe publikishtë shpallë

NË EMËR TË POPULLIT

AKTGJYKIM

I pandehuri: Idriz Ajvazaj me të dhënat personale si në shkresat e lëndës,

Është fajtorë

Më dt.12.01.2015 , rreth orës 14.45 min në rrugën regjionale Prishtinë- Gjilan , në fshatin Pasjak Komuna e Novobërdës , I pandehuri Idriz Ajvazaj , ka rrezikuar trafikun public , duke vë në rrezik jetën e ngrëzve dhe pasurinëe tyre , ashtu që duke drejtuar automjetin për transport, të udhëtarve – autobusin , e markës „Setra 215,,me targa të regjistrimit 06-392-BP , ka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjore neni 54.5 të LSKR-së , nuk ka përshtat shpejtësinë e lëvizjes , kushteve atmosferike të rrugës , për ta ndal automjetin para çdo pengese të paraqitur në rrugë , dhe me të arritur te rruga e fshatit Pasjak , nga pakujdeisa me pjesën e përparme të autobusit e godet në pjesën mbrapa automjetin e udhëtarve të markës VË Golf 19 , me targa të regjistrimit 06-709-AE, të cilin e drejtonte Muharrem Baliu , I cili në momentin kritik ishte ndal në rrugë , dhe kishte dhënë shenjë për tu kyqur në të majtë në drejtim të fshatit PASjak , dhe si pasojë e këtij aksidenti , përpos dëmeve material në të dy automjetet , lëndime të lehta trupore pësojnë vozitësi Muharrem Baliu , dhe pasagjerja e tij Vlora Baliu , që të dy nga fshati Livoq I Epërm , të ciët për shkak të natyrës së lëndimeve të pësuar detyrohen të kërkojnë ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit regjional të Gjilanit .

Me qka ka kryer veprën penale, Rrezikim I trafikut public nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së .

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së sipërtheksuar ligjore si dhe neneve: 4,41,46,73,74,75 dhe 76 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurit, i shqipton,

Dënim me gjobë

Ashtu që të pandehurin Idriz Ajvazaj e gjykon me denim me gjobë(me të holla) në shumë prej 200 € (dyqindë) Euro, të cilin denim ka për ta paguar në afatin prej 3 (tre) muajve nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën i njejt do të zëvendësohet me denim me burgim, ashtu që për 1 (një) ditë burgim do të llogaritet me 20 € (Euro).

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjygjësor të arkëtojnë shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

Të dëmtuarit Muharrem Baliu dhe Vlora Baliu , nga fshati Livoq i Epërm ,Komuna e Gjilanit për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në contest civil.

Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të aktgjykimit (të shkruar), në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Gjyqtari i vetëm gjykues e njofton të pandehurit se deri në përfundim të procedurës është i detyruar që ta njoftoi gjykatën për ndrrimin eventual të vendbanimit.

Prezentë Prokurori i Shtetit i pandehuri dhe të dëmtuarit e lartëcekur.

Aktgjykimi u komunikua më 21.09.2015, në ora 15.50

V e r t e t o j n ë :

Procesmbajtësja

Gjyqtari

P.nr. / 2013

Pasë fjalëve përfundimtare të palëve, gjyqtari merr dhe publikishtë shpallë këtë

NË EMËR TË POPULLIT

AKTGJYKIM

I pandehuri: Dragan Stojkoviç , me të dhënat personale si në shkresat e lëndës,

Është fajtorë

Më datën 28.07.2013 në mes ores 23.00 –m 24.00 min ne fshatin Kufce e Eperme të komunes së Novobëdrës në parkingun përpara shtëpisë së shëndetit me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër , nga automjeti i kësaj ambulance te markes Lada Niva me targë të regjistrimit 06-553 – AC , ka marr reth 30 litra benzine në atë mënyrë që ka hap deren e ketij automejti e me pas me dana e këput drynin i cili është vendosur ne kapakune rezervarit të benzinës dhe perms një gypi e nxjer sasinë e benzinës në fjalë dhe mere largohet në drejtim të stadinonit te shkolles se fshatit , ku dhe ndezë , dhe në këtë mënyrë për këtë sasi të benzines e dëmton të dëmtuarës – shtëpinë e shëndetit në fshatin Kufcë të Eperme të Novobërdës

-me çka ka kryerë veprën penale, Vjedhje e rëndë nga neni 327 paragrafi 1 i KPRK-se

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,41,45,46,50,51,52,73 dhe 75 të KPK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit, i shqipton,

Dënim me kusht

Me denim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (kater) muaj, si dhe denimi me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro , me kusht që i akuzuari brenda afatit prej 2(dy) viteve , nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi mos të kryejë vepër tjetër penale, në të kundërten dënimit me kusht kanë për t` ju revokuar.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjygjësor të paguaj shumën prej nga 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me kanosje përmbarimi.

I pandehuri obligohet që të dëmtuarës – drejtorisë për shendetësi dhe mirëqenie sociale të ja paguaj kompenzimin e demit .

Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të ushtrojn ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të aktgjykimit (të shkruar), në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Gjyqtari i vetëm gjykues e njofton të pandehurit se deri në përfundim të procedurës është i detyruar që ta njoftoi gjykatën për ndrrimin eventual të vendbanimit.

Prezentë i pandehuri dhe i dëmtuari të lartëcekur:

Aktgjykimi u komunikua në ora 12: 00.

Vërtetojnë:

Procesmbajtësja

Gjyqtari

P.nr.225 / 2013

Pasë fjalëve përfundimtare të palëve, gjyqtari merr dhe publikishtë shpallë

NË EMËR TË POPULLIT

AKTGJYKIM

Të akuzuarit :Qendrim Maliqi dhe Leonor Haziri , me të dhënat personale si në shkresat e lëndës,

Janë fajtorë

Me date 27.12 2012 , në kohë të papërcaktuar në fshatin koretishtë Komuna e Novobërdës saktësiht në fermën e pulave të pronarit Dushan Zhivkoviq , të pandehurit me qëllim të përvetsimit të kundëligjshëm pasuror për vete me force kanë hy në këtë object duke e thyer dritaren e të njejtit , dhe nga ky objekt kanë marrë një sasi kablllo elektrike , përafërsisht 24 kg , dhe të njejtit janë larguar nga vendi i ngjarjes , dhe në këtë mënyrë të dëmtuarin e kanë dëmtuar në vlerë të pa përcaktuar

-me çka kanë kryerë si bashkëekzekutor në bashkëveprim , veprën penale Vjedhje rëndë nga neni 253 paragrafi 1 nën paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së

